


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2855 REP

Nr. 322 KOL



KONTRATE SHIT - BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 03. 06. 2005 (dymijë e pesë), në Dhomën e Noterisë Tiranë, para meje Noteres **Violanda BECI**, me zyre në Rr. "Durrësit", Nr.37 u paraqitën personalisht palët e mëposhtme kontraktuese, të cilët kerkuan redaktimin e kësaj kontrate shitblerje si më poshtë :

Pala e Pare :

SHITES : **Arben PELLUMBI**, i biri i Servetit, i dtl. 1965, lindur e banues në Tiranë, Rr. "Pjeter Bogdani" Pall. Nr.39/1, me zotësi të plote juridike për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noterit, **me cilesine e Ortakut, zoterues i 30 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar në Shoqerine Tregtare "FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K.**

Pala e Dytë :

BLERES : **Bledar DOCI**, i biri i Skenderit, i dtl. 17.06.1974, lindur e banues në Tiranë, Rr. "Dull Keta", Nr.13/13, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noterit, mbajtes i Pasaportes Nr. Z 0532370.

OBJEKTI : Shitja e 10 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqerise Tregtare "FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K, nga Pala e Pare "Shitesi" dhe blerja e 10 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqerise Tregtare "FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K nga Pala e dyte "Bleresi".

Personat e mesiperm, në përputhje me vullnetin e tyre të lire të deklaruar dhe në Vendimet e Asamblese së Ortakeve dhe Aktet e tjera të Shoqerise paraqitur para meje, të cilët në vazhdim të kësaj kontrate do të thirren shkurt "Shitesi" dhe "Bleresi", me kerkuan hartimin dhe redaktimin e kontrates si më poshtë :

HYRJE

Sipas akteve të prezantuara përpara meje noterit, Vendimit Nr. 27115, date 06.02.2002 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Aktit te Themelimit, Statutit te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** dhe Vendimeve e Akteve te tjera deri me daten e sotme, rezulton qe Shitesi **Arben PELLUMBI** eshte Ortak ne Shoqerine Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** dhe zoteron 30 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar. Kapitali Themeltar i Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** eshte ne vleren prej 103.700.000 (Njeqind e tre milione e shtateqind mije) Leke.

KUSHTET DHE SHKAKU LIGJOR I LIDHJES SE KONTRATES :

Me date 11.05.2005, Ortaku i Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K**, Shitesi ne kete kontrate **Z. Arben PELLUMBI**, i eshte drejtuar Shoqerise me ane te njoftimit duke kerkuar mbledhjen e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise per te shqyrtuar kerkesen e tij per shitjen e 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar nga 30 % te Kuotave qe Shitesi zoteron me cilesine e Ortakut ne Shoqerine Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K**, duke ia ofruar per shitje Ortakeve te Shoqerise, **Z. Ilir SHTUFI dhe Z. Adrian DOCI**. Ne kushtet e ndodhura, te dy ortaket kane refuzuar oferten per blerje nga ana e Ortakut qe ia ofroi, prandaj ne keto kushte :

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** me Vendimin Nr.4, date 31.05.2005 ka vendosur : Miratimin i kerkeses se **Z. ARBEN PELLUMBI**, per transferimin (nepermjet shitjes) nga ana e tij te 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar nga 30 % i Kuotave qe zoteron ne Shoqerine Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** ne favor te personave te trete, jashte Shoqerise **Z. Bledar DOCI** me cmimin 10.370.000 (Dhjete milione e treqind e shtatedhjete mije) Leke. Hartimin dhe nenshkrimin e kontrates se Shit-Blerjes se Kuotave me Akt Noterial.

NENI 1

OBJEKTI

Objekt I kesaj kontrate eshte transferimi nepermjet shitjes te 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar nga 30 % te Kuotave qe Shitesi **Z. Arben PELLUMBI** zoteron me cilesine e Ortakut ne Shoqerine Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K** dhe kalimin e tyre nepermjet shitblerjes ne favor te **Bleresit Z. Bledar DOCI**, konform Vendimit Nr. 4, date 31.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K**.



Bleresi Z. Bledar DOCI, deklaron se e pranon blerjen e 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar nga 30 % te tyre, qe **Shitesi Z. Arben PELLUMBI** zoteron si Ortak ne Shoqerine Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K.**, konform Vendimit Nr. 4, date 31.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K.**

NENI 2

CMIMI DHE MENYRA E PAGESES

Cmim i shitjes do te thote cmimi i shenuar ne kete kontrate per shitjen e 10 % te Kuotave objekt te kesaj kontrate, cmim qe perfaqeson vleren monetare qe bleresi paguan si cmim shitje dhe shitesi e pranon kete shume dhe kete pagese si te tille.

Palet kane rene dakort qe Cmimi i shitjes se 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar objekt te kesaj kontrate, qe **Shitesi Z. Arben PELLUMBI** i shet **Bleresit Z. Bledar DOCI** dhe me te cilin ky i fundit i blen nga Shitesi eshte **10.370.000 (Dhjete milione e treqind e shtatedhjete mije) Leke.**

2.1 Shitesi si deklaron se ka marre teresisht dhe plotesisht jashte kesaj zyre noteriale shumen prej 10.370.000 (Dhjete milione e treqind e shtatedhjete mije) Leke, percaktuar me lart ne kete nen si cmim i shitjes se 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K.**, deklaron se eshte likujduar plotesisht nga bleresi me shumen prej 10.370.000 (Dhjete milione e treqind e shtatedhjete mije) Leke dhe nuk ka asnje pretendim lidhur per sa me lart.

NENI 3

STATUSI LIGJOR I KUOTAVE

Shitesi garanton Bleresin se Kuotat, objekt te kesaj kontrate jane plotesisht te disponueshme, te transferueshme dhe te lira nga cdo lloj pengu, hipoteke, apo barre tjeter ligjore. Pronesia mbi keto kuota kalon lirisht e parenduar nga cdo detyrim.

NENI 4

Pas nenshkrimt te kesaj kontrate, **Shitesi Z. Arben PELLUMBI**, zhvishet teresisht nga pronesia mbi 10 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar te Shoqerise Tregtare **"FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" SH.P.K.**, duke mbajtur 20 % te Kuotave te Kapitalit ne Shoqeri pas ketij veprimi. Shitesi humbet te gjitha te drejtat e pronesise mbi 10 % te Kuotave objekt te kesaj kontrate, te cilat kalojne ne pronesi te Bleresit.



NENI 5

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, **Shitesi Z. Arben PELLUMBI**, mbetet Ortak ne Shoqeri dhe ka ne pronesi te tij 20 % te Kuotave te Kapitalit Themeltar te Shoqërisë Tregtare "**FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO**" SH.P.K.

NENI 6 BAZA LIGJORE

Kontrata u hartua dhe redaktua bazuar ne Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", nenit 4 e vijues te Statutit te Shoqerise Tregtare "**FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO**" SH.P.K, nenet 705 e vijues te K.Civil, Ligjit "Per Noterine".

NENI 7 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Cdo mosmarreveshje mes paleve te kesaj kontrate zgjidhet me mirekuptim, e nese nuk arrihet zgjidhja, atehere palet mund t'i drejtohen gjykates. Kopetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 8 VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kontrata hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit te saj nga te dy palet.
Kontrata i detyron palet t'u permbahen kushteve te vendosura ne te.


Kjo kontrate hartohet ne 3 (tre) kopje origjinale, te njejta nga nje per seicilen pale dhe nje mbetet tek Une Noteri.

Kontrata u hartua dhe u redaktua ne prezence te paleve, iu lexua me ze te larte dhe palet pasi e degjuan, e kuptuan, deklaruan se e gjejne ne perputhje te plote konform vullnetit të tyre të lire, në prezencën time e pranuan aktin dhe e nënshkruajnë atë pa verejtje, ndersa Une Noteri, e vertetoj sipas ligjit.


PALET

SHITESI

ARBEN PELLUMBI

Arben Pellumbi


NOTER
VIOLE


Viole

BLERESI

BLEDAR DOCI

Bledar Doçi
